



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS
TIRANA PARKING

SPECIFIKIME TEKNIKE

1 - QELLIMI

- 1.1. Ne keto specifikime jepet zhvillimi i punimeve dhe kerkesat teknike per zbatimin e projektit.
- 1.2. Te gjitha kerkesat teknike te percaktuar ne keto specifikime jane te detyrueshme per kontraktorin e punimeve.
- 1.3. Projektet permbajne te gjitha te dhenat e nevojshme per zbatimin e punimeve, bazuar ne matje te sakta te kryera ne terren.
- 1.4. Per çdo mos perputhje te te dhenave te projekteve me gjendjen ne terren, te behet azhornimi i tyre nga zbatuesi i punimeve, dhe ne konsultim me investitorin, te behen ndryshimet perkatese, te cilat do te aprovohen nga punedhenesi.
- 1.5. Keto specifikime perfshijne te gjitha punimet per projektin e zbatimit te paraqitur.

2- PUNIMET E SHTRESAVE

2.1 Shtrese stabilizanti t=5cm

Shtresa e stabilizantit eshte percaktuar ne profilin terthor tip. Stabilizanti eshte parashikuar te prodhohet me material gurore te thyer ose zhavor lumi te thyer, te fraksionuar qe plotesojne kerkesat e meposhteme:

- Fortesia e gureve perberes 800 kg/cm² .
- Marka e thermimit nga prova Losanxhelos, LA 30 %.
- Permbajtja e argjiles deri ne 5 % dhe materjaleve organik deri ne 3 %.

Moduli i shkallezimit te fraksioneve do te jete sipas tabelës me poshte:

Dimensioni i sites ne mm	Kalimi ne site ne %	Mbetja ne sitene %
71	100	0
40	100 - 65	0 - 35
25	75 - 35	25 - 65
10	70 - 30	30 - 70
5	55 - 23	45 - 77
2	40 - 15	60 - 85
0.4	25 - 8	75 - 92
00.75	15 - 2	85 - 98

Pranohet luhatje 3 %

Materiali i ngjeshur ne veper duhet te plotesoje kerkesat e me poshteme:

- Indeksi i plasticitetit IP 6 - CBR minimale 80 %

- Densiteti minimal i matur i shtreses se ngjeshur dhe te thate duhet te jete 98 % e vleres Proktor i modifikuar.

Shtrimi i materialit do te behet ne te gjithë gjerësinë e sheshit me makineri (ose krahe).

Shmangiet e lejuara te sipërfaqes se perfunduar te shtreses do te jene brenda kufijve + 25 mm dhe – 15 mm, nga kuota e projektit. Per arritjen e treguesve te ngjeshjes, eshte e nevojshme te behet ngjeshja me rul vibrues me peshe 10 - 12 ton duke bere 12 kalime ne nje vend. Gjate ngjeshjes eshte e Specifikimet Teknike 8 nevojshme te behet sperkatje me uje per te arritur lageshtine optimale te ngjeshjes te percaktuar me pare ne laborator. Ngjeshja do te behet duke filluar nga anet ne drejtim te mesit te sheshit. Çdo kalim i mevonshem duhet te shkele gjurmen e meparshme 25 cm. Mbas ngjeshjes behet plotesimi me material te imet ne pjeset ku ka perqendrim te materialit te trashë. Ngjeshja quhet e perfunduar kur nje kokerr çakulli e hedhur mbi mbulesë thyhet nga rrota e rullit dhe nuk futet ne shtresen e stabilizantit. Levizja e trafikut, ne shtresen e perfunduar duhet te behet i alternuar, me qellim qe te shkelet e gjithë sipërfaqja.

2.2 Shtrese binderi me zall lavatrice, 4cm, me makineri

Ky seksion perfshin pajisjen dhe hedhjen e shtreses se pare (kryesore) bituminoze mbi nje shtrese baze (themel) te pergatitur ne perputhje me keto specifikime. Shtresat bituminoze qe do te perdoren jane

perzierje e agregat i nxehte, i thate dhe bitum i nxehte. Perzierja do te percaktohet ne perputhje me keto specifikime, te cilat bejne parashikimin per perdorimin e agregatit se bashku me bitumin e pershtatshem per te arritur kriteret ekerkuara. Masat nominale e perzierjes do te jete masa max. nominale e agregatit te perdorur. Perzierjet do te emertohen (identifikohen) nepermjet madhesise nominale ne mm.

Shtresa e **binderit 5 cm** eshte parashikuar te behet me materjale gurore te thyer, qe plotesojnekerkesat e meposhteme:

- Materiali gurore i thyer duhet te kete fortesine 700 - 900 kg/cm² dhe marke thermimi nga prova Losanxhelos LA⁻ 20 %
- Moduli i shkallezimit te fraksioneve (granulometria) do te jete si meposhte:

Dimensioni i sites ne mm	Kalimi ne site ne %	Mbetja ne sitene %
25	100	0
15	100 – 65	0 - 35
10	80 - 50	20 - 50
5	60 - 30	40 - 70
2	45 - 20	55 - 80
0.4	25 - 7	75 - 93
0.18	15 - 5	85 -95
0.075	8 - 4	92 -96

Pranohet luhatje | 2 %

- Para shtrimit te binderit behet pastrimi i shtreses se stabilizantit dhe pastaj behet sperkatje me bitum ne masen 0.5 Kg/m².
- Ngjeshja e shtreses do te behet me rul me peshe 10 - 12 ton me 8 - 10 kalime vajtje – ardhje ne te njetin vend.

PUNIME NE RRJETIN KUSH

Qëllimi

Ky seksion mbulon instalimet e nevojshme për të mbrojtur sipërfaqen nga permbytjet.

Seksioni përshkruan gjithashtu klasat e materialeve dhe kryerjen si duhet të punimeve.

NDËRTIMI

A) Gërmimi

Kanali duhet të gërmohet në thellësinë dhe gradën e dhënë. Një shtrat me mbushje granulare prej 100 mm trashësi (rëre) do të shpërndahet dhe ngjeshet siç kërkohet në projekt.

B) Materiali, Rëra

Me qëllim që të realizohet një shtrat solid, rëra do të përdoret si mbushje granulare.

Rëra e kërkuar do të ketë një kurbë granulare si:

10mm	100%
5mm	60-100%
1mm	40-90%
0.3mm	15-50%
0.075mm	2-15%

C) TUBOT E BRINJEUAR

Tubat e brinjezuar do të jenë HDPE, të dimensionit 200mm, për ujërat e shiut, të certifikuar nga CE.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETAJUARA SIPAS ZERA VE TE PREVENTIVIT.

Brenda çmimit njësi të çdo zeri punimesh do të përfshihet: Shpenzimet për blerjen e materialeve, shpenzimet për makineritë, shpenzimet për puntorinë, specialistët e manovratorët, përfshirë sigurimet shoqërore shëndetësore, shpenzimet për transportin e materialeve nga gurëthyeset/pikat e tregtimit etj deri në objekt apo nga objekti në piken e venddepozitimit të mbetjeve..

Gjithashtu në çmim do të përfshihen dhe shpenzimet për ngritjen e kantjerit, për provat laboratorike e testimet, shpenzimet suplementare dhe fitimi i planifikuar.

Gjithshtu në çmim do të përfshihen dhe shpenzimet e stafit inxhinierik e topogjeodezike.